

RAPORT

VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS

Objekti – Repart prodhime betoni

Vendndodhja – Qarku Korce, Bashkia Maliq, Fshati Zemblak

Pronar – Romeo MANKOLLI

PARATHENIE

Ne javen e katert te muajit shtator 2012 u be i mundur realizimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis per subjektin privat, person fizik, biznes i vogel, perfaqesuar nga zoti Romeo Mankolli, me aktivitet prodhim blloqe betoni

Ky aktivitet ka filluar nga puna para disa dhe vazhdon normalisht konform legjislacionit ne fuqi.

Godina e vogel qe sherben si zyre e subjektit dhe shtrimi e rregullimi i vendit ku zhvillohet aktiviteti eshte ndertuar ne truallin prone e vete z. Romeo Mankolli me miratim te KRT se komunes Pojan konform te gjitha rregullave dhe kerkesave.

Nga verifikimet e kryera me rezultoi se certifikata e pronesise se truallit te subjektit ne fjale rezultoi te jete krejtesisht e rregullt dhe ligjore.

Siperfaqia totale e ketij trualli eshte 1365 m2, ai ka brenda tij edhe siperfaqe rruge e sheshi si dhe siperfaqe te gjelbert.

Vend ndodhja e ketij aktiviteti eshte fshati Zemblak, rruga Korc-Bilisht, km. i 13-te, buze kesaj rruge ne krahun e majte, dhe realisht ndodhet nen juridiksionin e komunes Pojan.

Per te kryer aktivitetin e tij si subjekt priva ai ka paraqitur kerkese prane QKL Tirane per tu paisur me autorizim mjedisor, eshte i regjistruar dhe ka mare leje ushtrim aktiviteti ne komunen Pojan, si dhe ka numer idendifikimi ose nipti me inicjalet K 24020002 A.

Njeherazi subjekti qe kryen kete aktivitet eshte interesuar per krijimin e kushteve qe kerkon vleresimi i ndikimit ne mjedis, gje per te cilen i siper permenduri ka paraqitur dokumentat e duhura teknike dhe ligjore.

PROCESI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS U REALIZUA SIPAS KETYRE ETAPAVE:

- Njohja me subjektin qeushtron aktivitetin ne fjale.
- Njohja me objektin ku zhvillohet aktiviteti.
- Njohja me problematikat dhe procedurat e punes.
- Njohja me linjat teknologjike dhe proceset ne to.
- Njohja me produktin qe prodhohet e tregetohet.
- Idendifikimi i lendeve te para dhe ndihmese qe perdoren ne procesin e prodhimit.
- Lista e materialeve qe prodhohen e tregetohen.
- Idendifikimi i mbetjeve dhe shkarkimeve qe krijohen gjate proceseve te punes.

SHKARKIME QE SIPAS NATYRES SE TYRE NDAHEN:

1. Shkarkimet ne ajer.
2. Shkarkimet ne uje.
3. Shkarkimet ne toke (Mbetjet e ngurta etj qe rrjedhin prej procesit te punes)
4. Idendifikimi dhe mundesia e minimizimit dhe permiresimit te tyre.

REZULTATET E VLERSIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE SUBJEKTIT
PRIVAT "MANKOLLI" REPART PRODHIM BLOQE BETONI PARAQI-
TEN NE MATERIALIN SI ME POSHTE:

- Realizimin e bilancit te shkarkimeve ne ajer.
- Idendifikimin e shkarkimeve ne uje.
- Percaktimi i mbetjeve te ngurta dhe trajtimi i tyre, te gjitha keto ne ndikimin e vleresimit te ndikimit ne mjedis.
- Hartimi i programit te monitorimit dhe analizave te ndotjeve ne mjedis.
- Nxjerjen e rezultatit perfundimtar per hartimin e vleresimit ne mjedis.

RAPORTI PERFUNDIMTAR DO TE BAZOHET NE SHTJELLIMIN E
TEMAVE TE ME POSHTEME:

- 1-. Te dhenat mbi subjektin.
- 2-. Te dhena mbi aktivitetin
 - 2.1 Kapaciteti tregetues.
 - 2.2 Vendndodhja e objektit.
 - 2.3 Kushtet klimaterike te zones.
 - 2.4 Popullsia
 - 2.5 Bimesia dhe gjallesat.
 - 2.6 Punesimi.
- 3-. Pershkrimi i Teknologjise
 - 3.1 Njohuri te pergjitheshme.
 - 3.2 Linjat dhe repartet.
 - 3.3 Proceset kryesore.
 - 3.4 Lenda e pare.
 - 3.5 Lendet Ndhimese
 - 3.5.1 Energjia elektrike.
 - 3.5.2 Ambalazhi.
 - 3.6 Produkti.
- 4-. Shkarkimet ne mjedis.
 - 4.1 Idendifikimi i shkarkimeve.
 - 4.2 Shkarkimet ne ajer.
 - 4.2.1 Burimet e pa levizeshme te ndotjes.
 - 4.2.2 Burimet e levizeshme te ndotjes.
 - 4.2.3 Klasifikimi i burimit te ndotjes.
 - 4.2.4 Normat e lejuara te shkarkimeve.
 - 4.3 Mbetjet e ngurta.
 - 4.3.1 Sasite dhe natyra e mbetjeve.
 - 4.3.2 Trajtimi i mbetjeve.
 - 4.4 Shkarkimet ne ujra.
 - 4.4.1 Sigurimi i ujit te pijeshem dhe teknologjik.
- 5-. Ndikimi ne Mjedis
 - 5.1 Klasifikimi i ndotesve.
 - 5.2 Ndikimi ne cilesine e ajrit.

- 5.2.2 Sasite e shkarkuara ne atmosfere.
- 5.3.2. Aroma stimuluese.
- 5.4Ndikimi ne ujrat siperfaqesore.
- 5.5Ndikimi ne ujrat nentokesore.
- 5.6Ndikimi ne shendetin e punonjesve.
- 5.7Ndikimi ne shendetin e popullates.
- 5.8Ndikimi mbi bimesine.
- 5.9Ndikimi mbi gjallesat.
- 5.9.0Ndikimi mbi relievin dhe klimen.
- 6-. Masat per mbrojtjen e mjedisit.
- 6.1 Per mbrojtjen e cilesise se ajrit.
- 6.2 Per mbrojtjen e ujrave siperfaqesore.
- 6.3 Per mbrojtjen e ujrave nentokesore.
- 6.4 Per trajtimin e mbetjeve te ngurta.
- 6.5 Per ruajtjen e shendetit te popullates.
- 6.6 Eleminimi i zhurmave.
- 6.7 Problemi i korozionit.
- 6.8 Sistemimi i territorit.
- 7-. Plani i masave per minimizimin e ndotjeve
- 7.1 Per shkarkimet ne ajer.
- 7.2 Per shkarkimet ne uje.
- 7.3 Per shkarkimet e ngurta.
- 8-. Per monitorimin e vazhdueshem te ndotjeve
- 9-. Perfundime.

1-. TE DHENA MBI SUBJEKTIN.

Subjekti privat, "Mankolli", biznes i vogel, perfaqesuar nga zoti Romeo Mankolli zhvillon aktivitetin si me siper ne nje ambient te shtruar me cemento, te niveluar dhe rregulluar sipas natyres se produktit dhe procesit teknologjik te tij. Ky ambient ka nje siperfaqe totale prej 1365 metro katrore. Ndertimi i zyres se vogel dhe per rjedhoje edhe i gjithe ambjenteve te tjera si ai i repartit te prodhimit te blloqeve te betonit dhe ambjeteve te tjera ndihmese te magazinim shperndarjes te lendes se pare dhe produktit te gateshem, ai i parkimit te mjeteve, banjos etj eshte bere sipas nje projekti te projektuar me kujdes, konform te gjitha kerkesave ligjore urabanistike si dhe duke respektuar infrastrukturen e kerkuar nga ana e institucioneve te specilaizuara si per ujesjelles kanalizimet, ashtu edhe per anen elektrike dhe inspektoriatit sanitar shteteror. Ambienti ka hapësirat e nevojeshme, ndarje e pershtatje sipas natyres prodhimit e tregtimit te blloqeve te betonit qe prodhohen, eshte i rrethuar, ka sistem kanalizimesh dhe furnizimi me uje, ambient i brenda dhe jashte eshte i sistemuar, pjesa e poshteme ne masen dermuse eshte e shtruar me cemento, si dhe ka gjelberim te mjaftueshem.

Aktiviteti ne fjale zhvillohet buze rruges Korce-Bilisht,ne km. e 13-te,ne krahun e majte te saj..

Zona prane tij eshte zone ku ushtrojne aktivitetet edhe 3-4 biznese te tjera me natyre te ndryshme,kjo zone eshte e pak e populluar.

2-.TE DHENA MBI AKTIVITETIN

2.1 Kapacitetet prodhuese dhe tregetuese.

Subjekti ne fjale zhvillon nje biznes ne fushen e prodhimit te blloqeve te betonit,te cilet perdoren kryesisht per ndertim muresh rrethimi.

Blloqet e betonit qe pershkruam me siper dhe qe prodhohen ne kete subject prodhimi,jane cilesore,ato kerkohen ne tregun e zones nga fshatare te saj,si dhe plote sojne kushtet e percaktuara ne standardin apo kushtin teknik te ketij artikulli si per dimensionet ashtu edhe per parametrat cilesore.

Si lendet e para ashtu edhe produkti qe rezulton nga perpunimi i tyre i neneshtrohen jo ne vazhdimesi analizava laboratorike.

Disa nga treguesit cilesore te lendeve te para jane:

Granulometria e pluhurit te granilit dhe granilit te fraksionuar,pesha specifike dhe volumore e tyr,volume ne boshllek,papastertia dhe lendet organike te granilit,maraka e cimentos,imtesia e bluarjes dhe ndryshimi uniform i volumit te saj.

Sasia mesatare vjetore e blloqeve te betonit qe prodhohen e tregetohen ne kete subject apo reparat prodhimi eshte 180.000-200.000 cope.

Tregu i shitjes se ketyre blloqeve te prodhuar eshte kryeisht ai i banoreve te fshatrave qe jetojne e banojne ne afersi te tij.

Kerkesa per kete artikull ka tendence ritje pasi edhe cilesia ka permiresime te ndjeshme nga njeri vit ne tjetrin.

Ne kete reparat prodhimi jane te punesuar 3 puntore.

Bazuar ne legjislacionin aktual te mjedist si dhe referuar kapacitetit prodhues,mendoj se subjekti ploteson kriteret per realizimin e raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis.

Detyrimi i subjektit per t'u paisur me autorizim mjedisor vjen nga zbatimi i ligjit nr.8394 dt.05.09.2002"Per mbrojtjen e mjedisit" si dhe i vendimit te K.M 805 dt.04.12.2003, "Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis",subjekti ne fjale perfshihet ne aneksin nr.1,lista e veprimtarive vendore qe paisen me autorizim mjedisor.

2.2 Vend ndodhja e objektit

Subjekti privat prodhim blloqe betonii,ushton aktivitetin ne truallin prone e z.Shpetim Mankolli,ai ndodhet buze rruges Korce-Bilisht,prane fshatit Zemblak,komuna Pojan.Aktiviteti zhvillohet sipas projektit te hartuar dhe miratuar nga KRT e komunes Pojan ne vitin 2009.

Te dhenat e hollesishme te vend ndodhjes se tij jane pershkruar me siper por nuk mund te le pa permendur disa perparesi apo avantazhe qe paraqet ai:

- a-.Ka largesi te mjaftueshme nga vendet e banuara
- b-.Ndodhet prane rruges nacionale Korce-Bilisht dhe prane qendres se komunes.
- d-. Larg shqetesimeve te mundeshme per komunitetin per rreth tij.
- e-.Prane fuqise puntore ku zhvillohet aktiviteti.

2.3 Kushtet klimaterike te zones

Rrethi i Korces karakterizohet nga nje klime mesdhetare kontinentale me vere te thate e jo fort te nxehte e dimer te ftohte e me lageshti. Sasija mesatare vjetore e reshjeve arin ne 650 mm shi ne vit.Ne stinen e veres temperaturat maksimale luhaten ne + 34-36 grade celsius ne vere dhe deri ne minus 17-18 grade celsius ne dimer. Gjate vitit ka mesatarisht rreth 40 dite me ngrica.Drejtimi i ererave ne dimer eshte kryesisht nga veriu dhe ne vere ererat fryjne nga jugu dhe jug lindja.

2.4 Popullsia.

Nga subjekti privat aktiviteti zhvillohet sic e thame me siper ne periferi te fshatit Zemblak dhe te qendres se komunes Pojan.dhe si i tille ai ndodhet ne nje zone me nje popullsi jo fort te dendur.Me shume prane ketij aktiviteti ka disa biznese te llojeve dhe natyrave te ndryshme qe per nga numeri e kalojne shifren 4.

2.5 Bimesia dhe gjallesat.

Prane zones ku zhvillohet ky aktivitet si dhe ne nje teritor me te gjere prane vend ndodhjes se tij ndihet nje aktivitet i larmishem duke perfshire ketu edhe ato bujqesore si pemtari e blegtori.

Po ashtu ne kete zone cfaqet nje faune relativisht e pasur.

Jeta e botes e gjallesave kryesisht perbehet dhente,lopet,shpendet shtepiake,nga gjitare te vegjel predominon miu i arave,ndersa nga shpendet trumcaket, dallendyshja e shume ralle lejleku.

Vlen te theksohet se nuk ka specie te rezikuara apo te mara ne mbrojtje te vecanta ne kete zone.

2.6 Punesimi.

Aktualisht ne kete aktivitet jane te punesuar 3 punonjes pjestare te se njejetes familje,ndersa synimi per nje te ardhme jo te larget eshte ritja e numerit te tyre.

3. Pershkrimi i teknologjise.

3.1 Njohuri te pergjitheshme.

Subjekti privat i prodhimit te blloqeve te betonit me pronar dhe ortak te vetem z.Romeo Mankolli,eshte me nje profil te percaktuar nga sektori i prodhimit me destinacion ndertimin e mureve rrethues

Lendet e para dhe ndihmese qe perdoren nga subjekti i cituar me larte jane:
Granili me fraksion 05 mm dhe 5/10 mm,cimentua e markes 400,uji dhe energjia elektrike

Te gjitha sa pershkruam me siper blihen ne tregun e shitjes se tyre sipas nevojave procesit teknologjik,e diktuar kjo edhe nga kerkesat e tregut.Shpesh here prodhika karakter sezonal sepse gjate muajave te dimrit thuajse nuk punohet.

Lendet e para dhe ndihmese duhet te plotesojne kerkesat cilesore qe jane percaktuar ne standardet sheterore apo kushtet teknike per sejcilin artikull qysh ne momentin e blerjes se tyre ne tregun vendas.Pas mbritjes se tyre ne vendin e prodhimit keto lende te para sistemohen te ndara vec e vec,me pas kontrollohen nga ana cilesore,magazinohen dhe keshtu jane gati peperpunim.

Depozitimi dhe magazinimi behen ne ambiente te hapura.

Ne te gjitha rastet sejcila lende e pare apo ndihmese qe hyn ne kete subjekt shqerohet me dokumenta te rregullta si dhe me certefikate origjine apo cilesie.

3.3 Proceset kryesore.

Proceset kryesore qe do te ndjeke subjekti per aktivitetin normal te prodhimit te blloqeve te betonit jane:

a.Sigurimi i lendes se pare dhe ndihmese,me te cilen do te realizohet prodhimi i produktit te gateshem.Keto lende te para e ndihmese ne menyre analiktike i kemi pershkruar mesiperAto blihen ne tregun vendas sipas nevojave konkrete ne sasine dhe cilesine e duhur.

b.Lenda e pare e ndihmese e sjelle qe do te perdoret ne procesin e prodhimit,pasi shkarkohet,verefikohet,kolaudohet nga ana cilesore dhe me pas sistemohet ne ambient te hapur sipas natyres se saj dhe kerkesave te duhura,behen hyrje me dokument te rregullt dhe keshtu jane gati per procesin e prodhimit.

3.3/1.Procesi teknologjik.

Procesi teknologjik i prodhimit te blloqeve te betonit kalon ne keto faza:

Sipas nje recepture te caktuar te perberjes se lendeve te para,qe jane:

Granili 05 mm,granili 5/10 mm,cimentua e markes 400 dhe uji,behet perzjerja e tyre ne betoniere veterotulluese,kjo perzierje realizohet per 7-8 minuta,nga ky proces rezulton llaci,i cili me me anen e karocave te dores hidhet ne presen hidraulike,ne te cilen realizohet,vibrimi dhe ngjeshja.Vibrimi realizohet per 20 sekonda,ndersa ngjeshja per 7-8 sekonda.

Betonieria dhe presa hidraulike punojne me energji elektrike.

Prej kendej blloqet i neneshtrohen procesit te tharjes koha e se ciles varet nga temperatura e ambientit, keshtu ne mujat qershor-korrik-gusht nevojiten deri 72 ore per tharjen ndersa ne muajt shtator tetor nevojiten deri 192 ore per tharje. Prodhimi ka karakter sezonal, mesatareisht punohet vetem gjysmen e vitit. Prosesi i transportimit dhe shitjes se produktit te prodhuar realizohet nga vete subjekti prodhues me mjetet e tij.

Dimensionet e blloqeve te betonit jane:

Gjatesi 37 cm, lartesi 18 cm dhe gjeresi 17 cm.

Raporti i perzjerjes per 4 karoca eshte:

2 karoca pluhur granili 0.5 mm, 2 karoca granil 5/10 mm, 1 qeske ose 50 kg cimento marka 400 dhe 30 litra uje.

Nje karoce sipas perllogaritjeve rezulton te kete 0.083 m³ lende te perzjere Blloqet e betonit ne strukturen e tyre kane dy vrime.

3./3/2 Prosesi i furnizimit me energji elektrike.

Procesi i furnizimit me energji elektrike realizohet nga rjeti qendror i shperndarjes se zones elektrike CEZKorce, me te cilen subjekti ka lidhur kontrate furnizimi.

Furnizimi me energji elektrike gjate kohes se nderprerjes se saj nese do te ndodhe nga rjeti nuk perben ndonje pengese, keshtu qe subjektit nuk i nevojiten burime te tjera energjie si gjeneratori etj.

Sasia mesatare mujore e energjise elektrike qe do te harxhohet ne kete subjekt eshte rreth 350-380 kw ne muaj.

Fuqia elektrike e instaluar eshte rreth 25 kv.

3.4 dhe 3.5 Lenda e pare.

Lendet e para dhe ndihmese jan:

Pluhuri i granilit, granili, cimentua, uji dhe energjia elektrike.

Te gjitha nga sa me siper sigurohen duke u blere ne tregeun sipas rastit dhe nevojave qe do te paraqiten.

3.5.1 Furnizimi me uje.

Ne kete subjekt apo repart prodhimi me siperfaqe ndertimi rreth 1365 m² instalimet hidraulike, ato te shkarkimit te ujrave te bardheae te zeza, jane bere konform te gjitha kerkesave te nevojeshme qysh ne procesin e ndertimit ne gjithe teritorin e tij. Uji i nevojeshem per kete aktivitet meret teresisht nga nje pus i hapur enkas per kete qellim fare prane repartit te prodhimit

3.5.2 Amballazhi.

Specifika e punes se subjektit ne fjale perdor si amballazh paletat e drurit, qeset e letres se cimentos etj sipas nevojave.

3.6 Produkti.

Sic e kemi theksuar me siper produkti qe prodhohet eshte nje artikulli vetem,blloqet e betonit me permasat qe thame me siper.

3.6/1.Makinerite dhe paisjet e instaluara.

Per realizimin e procesit te prodhimit te blloqeve te betonit subjekti ne fjale disponon dhe ka te montuara keto makineri e paisje:

Betoniere cope 1,ajo punon me veterrotullim,kapaciteti i saj eshte 0.332 m3 per nje rast perdorimi..

Prese hidraulike automatike cope 1.

Pirun me kapacitet 2 ton,cope 1.

Kamjon me kapacitet 8 ton per furnizim shperndarje.

Karoca dore cope 10.

Keto makineri e paisje jane blere kohet e fundit ne tregun grek dhe jane te kohes.

4-. Shkarkimet ne mjedis.

Zhvillimi i aktivitetit te subjektit,prodhim dhe tregetim blloqesh betoni do te shoqerohet me shkarkime te limitizuara ne mjedisin per rreth,shkarkime te cilat nga verifikimet dhe sondazhet qe bera me rezulton qe jane ne nivel te ulet.

4.1 Idendifikimi i shkarkimeve.

Nga aktiviteti i prodhimit te blloqeve,qe jane objekt i punes se subjektit qe po analizojme rezultojne shkarkime qe prekin te tre elementet kryesore te mjedisit:

a.Shkarkime ne ajer.

b.Shkarkime ne ujra.

c.Mbetje te ngurta ne toke.

4.2 Shkarkimet ne ajer.

Shkarkimet ne ajer si burime te ndotjes se pa levizeshme mund ti quajme ato gjate procesit te ngarkimit e shkarkimit te lendeve te para,ndihmese si dhe te produktit te gateshem,etj si dhe ato qe formohen gjate procerseve te punes apo te prodhimit..

4.3 Mbetjet e ngurta

4.3.1 dhe 4.3.2 Sasite,natyra dhe trajtimi i mbetjeve.

Ne rastin konkret natyra e punes krijon mbetje te ngurta,ndonese sasia e tyre eshte e vogel,perseri ato vleresohen ne masen e duhur nga pronari i subjektit.

Keto mbetje perfaqesohen nga qeset e letres dhe paletat e ambalazhimit te cimentos te demtuara,si dhe nga mbetje apo papasterti qe rezultojne gjate procesit te prodhimit

Sasia mesatare javore e ketyre mbetjeve arin ne masen 30-35 kg,ne rastet kur punohet.Fillimisht keto mbetje depozitohen ne nje vend te caktuar dhe te siguruar dhe me pas perdoren me nikoqirlllek sipas nevojave per shitje tek te tretet ose per perdorim vehtiak.

Ndersa mbetjet ne sasira te vogla nje here ne dy dite prej nje punonjesi te caktuar pasi jane vecuar me pare ne nje vend te caktuar jashte reparteve te punes,cohen apo depozitohen ne vendin e caktuar nga komuna PoJAN.

Per kete problem subjekti ne fjale rakordon shpesh here me drejtuesit e komunes Pojan.

4.4 Shkarkimet ne ujra.

4.4.1 Sigurimi i ujit te pijeshem dhe atij teknologjik.

Sigurimi i ujit ne subjekt behet sic e spjeguem me siper,sigurohet nepermjet nje pusi te hapur posacerisht ne pjesen jugore te reaprtit te prodhimit.

Sasia e ujit eshte e mjaftueshme,ai eshte i paster dhe me tregues laboratorike normale.

Ky uje perdoret si lende e pare ne prodhim si perzjeres,per sperkatjen e blloqeve te prodhuar,per larjen e puntoreve e banjos.

4.4.2 Shkarkimet ne ujra.

Duke qene ndertim dhe aktivitet i ri,ai eshte i paisur edhe me sistemin e shkarkimit te ujrave te bardha e te zeza.Ky sistem eshte i ndare vec per ujrata e bardha e vec per ato te zeza,ai eshte i paisur me puseta dekantuese.

Keshtu realizohet dekantimi i plote i pezullive qe ka mare uji.

Per shkarkimin e tyre perdoret rjeti I shkarkimit te fshatit Zemblak i cili funksionon mire.

Gjate procesit te prodhimit nuk rezulton te kete rjedhje te ujrave kjo edhe per shkak te pjeresise dhe pozicionit te vendit dhe rjetit te kanalizimeve per furnizimin me uuje dhe pert shkarkimin e tij.

5-. Ndikimi ne mjedis.

Mjedisi ndikohet nga shkarkimet e elementeve te ndryshem ne ajer uje toke si dhe nga vetite qe paraqesin keta elemente ne lidhje me ndikimin e tyre ne mjedis.

5.1 Klasifikimi i ndotesve.

Ndotsit klasifikohen ne ata me ndikim ne ajer,ne ujra(siperfaqesore dhe nen tokesore)si dhe ne mbetje te ngurta.

5.2 Ndikimi ne cilesine e ajrit.

Aktiviteti qe zhvillon subjekti i cituar me siper ne ambjentine prodhimit te blloqeve me siperfaqe totale 1365m2 ndodhet ne juridiksionin e komunes Pojan, buze rruges Korce-Bilisht, km.13-te I saj, mendoj se permbush kriteret per normat e shkarkimeve ne ajer te cilat nga sa konstatova kane ndikim te vogel ne ndryshimin e cilesise se ajrit.

5.2.1 Sasite e shkarkuara ne atmosfere.

Ne kete subjekt mendohet qe shkarkimet ne atmosfere te jene ne mase jo te vogel. Ketu behet fjale per grimzat e ngurta dhe pluhurnat gjate proceseve te ngakim shkarkimit te lendeve te para, gjate procesit te prodhimit si dhe ndikimet e tjera gjate aktivitetit te prodhimit te blloqeve.

5.2.2 Aroma stimuluese.

Aktiviteti eshte i tille qe nuk dallohet per aroma stimuluese.

5.5 Ndikimi ne ujrat siperfaqesore.

Ne teritorin ku ndodhet dhe ushtron aktivitetin e tij biznesi objekt studimi me masat e mara qe ne ndertim per kanalizimet e brendeshme si dhe pusetat behet i mundur limitizimi i permbajtjeve ne suspension te grimcave te ngurta ne ujrat siperfaqesore.

5.4 Ndikimi ne ujrat nentokesore.

Te gjitha shkarkimet apo mbetjet ne keto ujra kane natyre te biodegradueshme dhe si te tilla minimizojne plotesisht mundesine e ketij kontaminimi ne bazenin uje mbledhes.

5.5 Ndikimi mbi shendetin e punonjesve.

Ky aktivitet me tre punonjes, eshte i kushtezuar me mbajtjen paster te ambjenteve te punes dhe respektimin korekte te kushteve higjieno sanitare. Nga sondazhet e kryera me rezulton se nuk ka ndikime mbi shendetin e punonjesve te punesuar.

5.6 Ndikimi mbi shendetin e popullates.

Objekti i subjektit privat qe funksionon ne adresen e siper permendur ne periferi te qytetit te fshatit Zemblak dhe komunes Pojan, eshte nje premise pozitive per mos ndikime negative ne shendetin e popullates. Kjoi bazuar ne masat e mira qe ka mare dhe zbaton me korektesi pronari i vetem i ketij subjekti.

5.7 Ndikimi mbi bimesine.

Nuk vrehet ndonje ndikim negativ ne bimesine e ndodhur gjate zhvillimit te aktivitetit,nuk ka gjate shkarkimit te ujrave efekte negative mbi bimesine.

5.8 Ndikimi mbi gjallesat.

E njejta gje si per bimesine eshte edhe per gjallesat.

5.9 Ndikimi mbi relievin dhe klimen.

Gjate zhvillimit te aktivitetit te subjektit nuk vrehet ndonje ndikim mbi relievin apo klimen,nuk te pasqyrohet asnje efekt mbi to.

6-. Masat per mbrojtjen e mjedisit.

Mbrojtja e mjedisit eshte pjese perberse e interesimit te subjektit ne fjale pa terhequr asnjehere vemendjen gjate zhvillimit te aktivitetit.

6.1 Per mbrojtjen e cilesise se ajrit.

Ajri ne kete subject mund te infektohet nga grimxat e lendeve te para,pluhurnat,tymrat apo gazi i mjeteve levizese.

Kujdes i vecante tregohet prej pronarit per mirembajtjen e mjeteve levizese qe ai kane ne disponoin per furnizim shperndarje nje kamjon 8 ton,si dhe nje pirun 2 ton,per pastrimin e ambjenteve te punes,transportimin ne kohe te mbetjeve dhe pastrimin e teritorit per rreth detyra keto qe jane nje kerkese e domsdoshme dhe e vazhdueshme.

Po ashtu kujdes tregohet edhe per mirembajtjen e betonieres dhe preses hidraulike ndaj te cilave kryhet sherbim per mire funksionimin e tyre.

6.2 Mbetjet e shkaktuara ne ujrat siperfaqesore.

Keto mbetje te mjedisit nga ambjentet e punes dhe per rreth kerkojne perdorimin e komponenteve specifike te punes,si realizimi i dekantimit te pezullive ne pusetat e shkarkimit ne sistemin e brendeshem te kanalizimeve,me qellim ne kanalet kullues ndikimet te jene te minimizuara.

6.3 Per mbrojtjen e ujrave nen tokesore.

Zbatimi i normave te lejuara te shkarkimeve eshte kushti kryesor per mbrojtjen e bazenit uJOR.Specifika e aktivitetit te subjektit ben te mundur qe te mos kemi ndikim apo komponent ndotes qe mund te krijohet e te jape ndikim negativ.

6.4 Per trajtimin e mbetjeve te ngurta.

Do te zbatohen udhezimet e dhena per trajtimin e mbetjeve te ngurta. Ato jane te perdoreshme per djegie si dhe te riciklueshme pasi mbas krijimit te tyre do te dergohen ne vendin e caktuar te grumbullimit te tyre.

6.5 Per ruajtjen e shendetit te popullates.

Themelore eshte zbatimi i normave te lejuara te shkarkimeve ne ajer, uje dhe ne trajtimin e mbetjeve te ngurta, ruajtja e kushteve higjieno sanitare pastrimi i ambjenteve te punes dhe per rreth tij per te shmangur formimin e ndonje vatre infeksioni. Meqene se keta tregues jane ne parametra te pranueshem nuk shoh asnje rezikshmeri mbi shendetin e popullates ndonese kjo eshte zone pake e banuar.

6.6 Eleminimi i zhurmave.

Burim i zhurmave te subjektit do te jene mjetet levizes te cilat duhet te mirembahen me kujdes, si dhe funksionimi i makinerive qe disponon subjekti, ne rastin konkret aktiviteti firmes ka nje ndikim te jo vogel ne prishjen e higjenes akustike per puntoret qe punojne aty por te paperfilleshem per zonat prane subjektit, kjo edhe per shkak se aktiviteti kryhet ne ambjent te hapur.

6.7 Problemi i korozionit.

Aktiviteti ne fjale nuk perben asnje problem ne lidhje me korozionin.

6.8 Sistemimi i territorit.

Teritori ku zhvillohet aktiviteti prodhues i ketij subjekti eshte teresisht i sistemuar, obori ne hyrje dhe rruget te shtruara, me bordura te rregullta, me gjelberim e pemtari, ndersa fasada e zyres teper te vogel eshte e suvatuar dhe e lyer, kujdes duhet treguar ne pjesen e mbrapme te ketij reparti prodhimi per te mos lejuar depozitim amballzhesh apo snedesh te tjeta te pa nevojeshme.

7. Plani i masave per minimizimin e ndotjeve..

Ky plan do te jete prioritet gjate punes.

7.1 Per shkarkimet ne ajer.

Si burim i shkarkimeve ne ajer per kete subject jane:

Mjetet levizese qe permendem me siper.

Per minimizimin e ketyre shkarkimeve, mbetet detyre e vazhdueshme kryerja e sherbimeve periodike ndaj tyre duke respektuar grafikun e hartuar per kete qellim.

7.2 Per shkarkimet ne uje.

Duhet te jete e vazhdueshme mirembajtja e rjetit kullues,per kete qellim nepermjet laboratorit kimik prane DSHSP Korce te kontrollohet ndryshimi i pezullive ne uje gjate kohes se punes kur akiviteti zhvillohet.

7.3 Per shkarkimet e ngurta.

Si e kemi permendur me lart per natyren e tyre mbetjet e ngurta riciklohen ndonese sasia e tyre eshte jo e konsiderueshme.

7.3.1. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri dhe sigurimi teknik

Reparti ne fjale eshte i paisur me mjete mbrojtese nga ndonje zjarr i mundeshem,ai disponon 2 cope zjarrfikse te medha dhe 2 te vogla,punonjesit jane te njohur me masat qe duhen mare per kete problem,pa ashu ata perdorin mjete mbrojtese gjate punes si dhe kane njohuri edhe per sigurimin teknik te tyre. Nuk mungojne edhe tabelat perkates,kujdes nga tensioni,kujdes nga makinat dhe rreziku i zjarrit.

7.3.2.Terheqia e mendimit te komunitetit.

Bazuar ne orientimet e organeve te specializuara,gjate kohes se inspektim verifikimeve per plotesimin e kushteve,nga ana ime u pyeten disa biznese apo kalimtare te rastit,nga ku nuk me rezultoi asnje vrejte apo ankese e cfardo natyre qofte ajo.Ky fakt vertetehet edhe ne process verbalin e mbajtur per kete qellim si dhe ne deklaraten e dy bashkepronareve te ketij aktiviteti.

8-. PER MONITORIMIN E VAZHDUESHEM TE NDOTJEVE.

Monitorimi i shkarkimeve ne ajer dhe uje do te realizohet ne laboratorin kimik te DSHP Korce,ne menyre peregjithshme,dhe per cdo problem qe mund ta paraqese rezik ndotje te ambientit te njohet detyrimisht ARM Korce. Perfundimisht subjekti detyrohet te zbatoje programin e monitorimit te ndotjeve bazuar ne ligjin Nr.8934 dt.05.09.2002,"Per mbrojtjen e mjedisit" si dhe vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.805 dt.04.12.2003,"Per miratim. e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis",si dhe ne ligjet nr.9113 dt.24.07.03" Per ndotjet ne ujra" dhe ligjit 9010 dt.13.02.2002,"Per ndotjet ne toke"

9-.PERFUNDIME

VNM-ja shikohet ne perfundim te saj si e pranueshme,kjo konsiderohet edhe si nje ndihme e bashkepunim me subjektin per realizimin dhe vleresimin e te gjithë faktoreve qe kane ndikim ne mjedis.

Duke pare masat e mara ne teresine e tyre ne permushjen e kerkesave te ligjshmerise mjedisore,menyren e organizimit te punes per prodhimin dhe shperndarjen e artikujve qe prodhohen e tregtohen qe konkretisht jane vetem blloqet e betonit,impenjimin per realizimin e monitorimeve te shkarkimeve si dhe permiresimet e treguesave te tjera mjedisore,qysh ne fazen fillestare te projektimit dhe me pas ate te ndertimit te ketij subjekti,mendoj dhe per kete jam i bindur se aktiviteti qe kryejn subjekti nuk do te kete asnje pasoje negative te dukeshme mjedisore qe mund te sjelle probleme me ndikim ne mjedis.

Specifika e punes se ketij aktivitetii ne repartin e prodhimit te blloqeve kerkon nje vemendje te posacme per kujdesin qe duhet treguar ne fushen e sigurimit teknik te punonjesve qe aktualisht punojne ketu si dhe ruajtjen e shendetit te tyre nga pluhuri,grimxat dhe tymrat qe krijohen gjate procesit te prodhimit te blloqeve. Kujdes i posacem te tregohet per kryerjen e analizave laboratorike te blloqeve te betonit qe prodhohen,gje per te cilen vihet detyre te behen analizat e tyre ne nje laborator te licensuar,keto analiza te behen ne vazhdimesi dhe cdo parti malli qe shitet te shoqerohet ne flete analizen perkatese laboratorike.

Ne keto rethana mendoj se subjekti ne fjale duhet paisur me autorizim mjedisor.

Eksperti i vleresimit te ndikimit ne mjedis

Baki Shahu

EKSPERT MJEDISI
BAKI SHAHU
Nr.Vendimi 2 Dt.30.04.08
Tel:0692521496